

THIRRJE PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR ORGANIZATAT JO- QEVERITARE QË OFROJNË TRAJNIME PËR AFTËSI TË BUTA PËR DERI 300 PUNËKËRKUES (MOSHA 18 – 24 VJEÇ) NË 7 QENDRAT KRYESORE TË KOSOVËS

Konteksti:

Në kuadër të implementimit të projektit “Fit for Jobs”, Agjencia e Punësimit së Republikës së Kosovës (APRK) shpall thirrjen për angazhimin e një (1) organizate, e cila ka target të rinjtë, për ofrimin e trajnimeve për aftësi të buta për deri 300 punëkërkues (mosha 18-24 vjeç) në 7 qendrat kryesore të Kosovës. Rrjedhimisht, nëpërmjet kësaj shpalljeje ftohen të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara që të aplikojnë për këtë mbështetje financiare. Në veçanti inkurajohen organizatat rinore të regjistruara të aplikojnë.

Qëllimi:

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është të përgatisë të rinjtë për tregun e punës gjegjësisht 300 punëkërkues (mosha 18-24 vjeç) përmes angazhimit të një organizate e cila ka target grup të rinjtë (psh.qendër rinore) e cila paraprakisht ka zhvilluar aktivitete të ngjashme për ngritjen e aftësive të të rinjëve, ka kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme në ofrimin e tranimeve për aftësi të buta, në mbarë Kosovën.

Për më tepër APRK zbaton këtë projekt i cili realizohet në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane përmes projektit të GIZ Kosova “Fit for Jobs”. Objektivi i këtij projekti është të rrisë mundësitë e punësimit të të rinjëve duke përmirësuar mundësitë e orientimit në karrierë, cilësinë e formimit profesional dhe shërbimet e kërkimit të punës si dhe një orientim më të fortë në tregun e punës.

Rezultati dhe Detyrat:

Për aktivitetin e lartëcekur, priten të realizohen rezultatet si në vijim:

Zhvillimi i një programi të trajnimit dhe mjete apo materiale trajnimi

l Ofrohen trajnime 2-ditore për aftësi të buta (Soft Skills) për 300 punëkërkuës (mosha 18-24 vjeç) në modulet e mëposhtme të trajnimit me këtë përmbajtje (por jo vetëm):

- o Aftësitë e buta për sigurim të një vendi të punës (aplikimi, intervista, e të tjera)
 - Si të kërkosh punë? Cilat janë teknikat për kërkim të strukturuar të vendit të punës ? Aftësitë komunikuese ; Ushtrime praktike për teknikat e intervistës për punë.
- o Aftësitë e buta përgjatë punës
 - Puna në grupe (aktivitet grupor); Zgjidhja e problemeve individuale/grupore ; Menaxhimi i kohës ; Etika ; Vendimmarrja;

Vlera e mbështetjes financiare:

Vlera e përgjithshme e planifikuar për këtë thirrje është EUR 5,600.00.

Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen:

Të jetë organizatë jo-qeveritare e regjistruar në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe që vepron në Kosovë të paktën një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

Të ketë fushë të veprimtarisë trajnimit e aftësive të buta.

Të zhvillojë të gjitha aktivitetet e organizatës sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

OJQ-të duhet gjithashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuese ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Trajnimi duhet të zbatohet një çasje e cila fokusohet në aftësi ose kompetenca specifike, dhe të paraqitet nëpërmjet një kombinimi në mes të rasteve studimore dhe demonstrimit praktik nga ana e praktikantëve. Pjesëmarrësit do të marrin pjesë në krijimin praktikë të një dokument aplikimi për punë (CV, Letër Motivuese), do të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme të cilat do t'u ndihmojnë atyre të tregojnë rezultatet të mira në raport me punëdhënësit pas përfundimit apo përgjatë Praktikës në Punë, 6 mujore, të ofruar nga MFPT përmes APRK-së.

Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e aplikimit:

Aplikacionet duhet të dërgohen përmes e-mail adresës aprk.info@rks-gov.net, prej dates 08.08.2022 deri më datën 22.08.2022, ora 16:00, dhe duhet të përmbajnë dokumentacionin në vijim:

- Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore
- Profili i organizatës dhe përvoja paraprake relevante
- Formulari i aplikacionit për projekt/propozim dhe propozim buxhetin si dhe Ofertën teknike (metodologjinë e punës) [1].
- CV e trajnerit/trajnerëve që do të angazhohen
- Preferohet certifikata e trajnerit për aftësi të buta (opsionale)
- Certifikata e regjistrimit të organizatës
- Lista e ATK-së
- Certifikatën e numrit fiskal

Procesi i përzgjedhjes:

Agjencia e Punësimit do të themelojë një Komision të pavarur për shqyrtimin e aplikacioneve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, Agjencia do të lidhë marrëveshje për përcaktimin e përgjegjësive të palëve me organizatat apo entitetet e aprovuara nga Komisioni.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm aplikacionet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Palët e interesuara mund të kërkojnë sqarime shtesë për këtë thirrje publike nëpërmjet email adresës aprk.info@rks-gov.net